

VENDIM
Nr.36, datë 18.1.2006

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.335, DATË 20.6.2000
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.335, datë 20.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Entet prokuruese, që prokurojnë fonde publike, në bazë të kërkesave dhe të fondeve të miratuara për mallra, shërbime dhe ndërtime, përgatisin dhe plotësojnë regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar në udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Një kopje e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, e miratuar nga kryetari i entit prokurues së varësisë, i dërgohet, brenda datës 20 janar të çdo viti, institucionit qendror, që vë në dispozicion fondet. Institucionet qendrore, brenda datës 15 shkurt të çdo viti, dërgojnë në Agjencinë e Prokurimit Publik e në Drejtorinë e Thesarit dhe Buxhetit, në Ministrinë e Financave, përmbledhjen e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike dhe të enteve të varësisë (nëse kanë). Drejtoria e Thesarit dhe e Buxhetit u dërgon nga një kopje degëve të thesarit në rrethe.

Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të të dhënave të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike, të dërguara nga institucionet qendrore, përgatit regjistrin qendror të parashikimeve të prokurimeve publike dhe e shpall atë në buletin e prokurimit publik, brenda muajit shkurt të çdo viti.

Organet e qeverisjes vendore dhe shoqëritë tregtare shtetërore dhe ndërmarrjet shtetërore dërgojnë përmbledhjen e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike në Agjencinë e Prokurimit Publik, sipas miratimit të buxhetit nga këshillat e qeverisjes vendore apo organet drejtuese të tyre.

Entet prokuruese, për fondet e krijuara ose të shtuara, hartojnë regjistrat shtesë për këto fonde dhe ua dërgojnë institucioneve qendrore. Në këtë rast, institucionet qendrore njoftojnë Drejtorinë e Thesarit dhe të Buxhetit, në Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Prokurimit Publik, të cilat bëjnë ndryshimet në regjistrat përkatës.”.

2. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Entet prokuruese, në fund të çdo 3-mujori, brenda datës 10 të muajve prill, korrik dhe tetor, të paraqesin në institucionin qendror, që vë në dispozicion fondet, treguesin për realizimin e prokurimeve të planifikuara, të shoqëruara me relacionin shpjegues. Institucionet qendrore, brenda datës 20 të muajve prill, korrik dhe tetor, të dërgojnë në Agjencinë e Prokurimit Publik, përmbledhjen e treguesve të realizimeve të tyre dhe të enteve të varësisë. Agjencia e Prokurimit Publik, brenda datës 30 të muajve prill, korrik dhe tetor, të paraqesë në Këshillin e Ministrave pasqyrën përmbledhëse të prokurimeve në shkallë vendi.

Entet prokuruese, në muajin janar të çdo viti, të përgatisin dhe të plotësojnë regjistrin e realizimit të prokurimeve publike të vitit pararendës, sipas modelit dhe mënyrës së përcaktuar në udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Një kopje e këtij regjistri, e miratuar nga kryetari i entit prokurues, i dërgohet, brenda datës 10 janar të çdo viti, institucionit që vë në dispozicion fondet. Këto institucione, dërgojnë në Agjencinë e Prokurimit Publik, brenda datës 20 janar, përmbledhjen e regjistrave të reealizimeve të prokurimeve publiketë tyre dhe të enteve të varësisë.

Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të të dhënave të regjistrave të realizimeve të prokurimeve publike, të dërguara nga institucionet qendrore dhe vendore, përgatit regjistrin qendror të

realizimeve të prokurimeve publike dhe e shpall atë në buletin e prokurimit publik, brenda datës 5 shkurt të çdo vitit.”.

3. Pas paragrafit të parë të pikës 13, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Agjencia e Prokurimit Publik është e detyruar të marrë vendim, brenda 10 ditëve nga marrja e raportit përmbledhës të rivlerësimit, të paraqitur nga enti prokurues.”.

4. Pas pikës 13 shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:

“13/1 Kontratat për mallra, shërbime apo ndërtime, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 5 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhen me afat deri në mbylljen e vitit buxhetor.

Kontratat për shërbimet komplekse, sipas përcaktimit të pikës 5 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, lidhen me afat deri në 5 vjet.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha